

Prof. dr. Xheladin SHALA

## ROLI I AZEM BEJTËS NË LUFTËN KUNDËR PUSHTUESIT SERB

**M**egjithëse kanë kaluar 80 vjet nga rënia heroike e Azem Bejtës, madhështia e tij si figurë eminente historike kombëtare sa vjen e rritet. Trimëria, guximi, vendosmëria dhe viktimizimi i pashembullt në aksionet e panumërta luftarake gjatë atyre dy dhjetëvjetshave të stuhishme të shek XX -para luftërave ballkanike dhe pas Luftës së Parë Botërore bënë që ai të zë një vend nderi në vargun e figurave më të shquara kombëtare. Pa dyshim, personaliteti dhe simboli numër një i luftës dhe i qëndresës së shqiptarëve të Kosovës kundër Serbisë pushtuese gjatë shekullit XX, deri në Epokën e UÇK-së 1997-1999, është Azem Bejtë Galica.

Gjatë 150 vjetëve të fundit shqiptarët e ish-vilajetit të Kosovës vazhdimisht ishin në gjendje lufte kundër pretendimeve të popujve fqinjë. Mirëpo, Serbia me aleatët e saj ballkanas e pushtuan Kosovën më 1912 dhe synim kryesor kishin shfarosjen e popullit shqiptar. Kosova, gjak e plagë shqiptari rrodhi, sidomos përreth një shekull nga pölitika militariste e Serbisë.

Kështu, "Shqipëria e ndarë mbeti e plagosur dhe e gjymtuar rëndë, ajo mbeti me liri e pavarësi të

paplotësuara, ndërsa Kosova, bija besnike e atdheut, mbeti e robëruar, viktimë e një tragjedie e gjenocidi të paparë".<sup>1</sup> Megjithë ato vuajtje të pakrahasuara dhe të pa shembullta në rruzullin tokësor, Kosova ishte dhe mbeti tokë thjeshtë shqiptare.

Ndërkaq, nga fillimi i vitit 1916 territorin e ish-vilajetit të Kosovës e pushtuan austro-hungarezët dhe bullgarët. Shqipërinë e 1913-s e pushtuan, pos dy shteteve të përmendura më lart. Qysh në atë vit Azem Bejta pati një takim me Hasan Prishtinën në Vushtrri lidhur me luftën kundër pushtuesve të huaj dhe ato lidhje do të jenë të përhershme deri në fund të jetës së tij. Gjithashtu, Azem Bejta do të bashkëpunoi me Sadik Ramën, Bajram Currin, Hysni Currin, Kadri Prishtinën si Kryetar i Komitetit Mbrojtja Kombëtare e Kosovës prej nga merrte udhëzime nga Programi i saj i shpallur në prill të vitit 1919.

Serbia, në saje të aleatëve anglo-francezë që e fituan Luftën e Parë Botërore, i ripushtoi tokat shqiptare. Veçanërisht ishte angazhuar Franca që e ndihmoi shumë krijimin e shtetit të madh në Ballkan, atë të Jugosllavisë, nën dinastinë e Karaxhorxheviqëve. Në këtë kontekst zhvillimesh Kosova u rrezikua si asnjëherë më parë. Kështu, ende pa u tharë gjaku i derdhur nga mizoritë e Serbisë, të viteve 1912-1915, në vjeshtë të vitit 1918 shqiptarët u përballën sërish me pushtuesit serbë, masakrat e të cilëve në mbamendjen e popullit ende ishin të freskëta.

Azem Bejta me njësitin e tij luftarak dha kushttrimin në mbrojtjen e tokës shqiptare për t'iu vënë përballë ambicieve të shfrenuara të politikës serbomadhe. Njësi i Azem Galicës shërbeu si bërthamë rreth të

1. Ajë Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë 1976, 21.

cilit silleshin edhe njësitë tjera çlirimtare të Kosovës. Në këtë mënyrë, politika e serbomëdhenjve hasi në rezistencën e popullit shqiptar të ish-vilajtetit të Kosovës dhe të atij të Manastirit. Ndërkaq, Serbia kërkonte dhe dëshironte nënshtrimin, përhapjen e frikës dhe turpin për shqiptarët e Kosovës, por kurrësesi shqiptar të fortë kombëtar e të vendosur.

Britma "O, prite, prite Azem Galicën!" u bë thirrje kushtrimi e mobilizimi - thirrje me të cilën armiku fitonte bindjen se Azem Bejta ishte kudo, thirrje që u ndie në të gjitha luftërat shqiptaro-serbe, në Drenicë e në Kosovë në përgjithësi gjatë kohës sa ishte gjallë, por edhe pas vdekjes.

Ndërkaq, Serbia nuk zgjidhte mjete me qëllim të pakësimit të shqiptarëve në Kosovë. Ajo synonte shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi, në Shqipëri. Popullit ishte i detyruar t'i rrokte armët e ta mbronte ekzistencën e vet me cilindo çmim. Kështu, Serbia gjithnjë përpiqej që t'i nënshtronte, duke vrrarë e masakruar pa dallim moshe e gjinie shqiptarët e Kosovës. Asaj nuk i pëlqenin fjalët që kishin marrë dhenë: "Azem Galica asht drague e fluturon me krah, nga një mal në tjetrin". "Azemi asht me orë të madhe", "ka shtatë zemra", "nuk e merr plumbi" etj. Madje, asokohe edhe serbët e pranonin se Azem Bejta ishte prijës i rezistencës shqiptare dhe gjithashtu kishin formuar bindjen se me asnjë çmim nuk mund ta luhasnin qëndrimin e vendosur për luftë të kryetrimin Azem Galica. Vërtet Azem Bejta, si udhëheqës i Luftës Çlirimtare Shqiptare kundër Serbisë, u bë legjendë në krahinën e Drenicës, dhe në të gjitha trojet shqiptare. Ai i shkaktoi telashe e kokëçarje të mëdha Serbisë pushtuese nga njëra anë, kurse nga ana tjetër popullit

shqiptar iu shtua besimi dhe shpresa se edhe për të kishte se kush të kujdesej. Në disa vende pushtetin faktik e kishin njësitë çlirimtare të Azem Bejtës, Mehmet Konjuhiti, Bel Bajçinofciti, Kalosh Zajaziti etj. Gjithashtu, ideologu i mirënjohur i Luftës Çlirimtare, Hasan Prishtina, kishte besim të madh në trimërinë, vendosmërinë dhe sakrificën e pashembullt të Azem Bejtës dhe Shotë Galicës. Ata më së miri e kuptonin se një komb që nuk vepron në pajtim me kërkesat historike të kombit në momentet vendimtare, përballet me grindjen dhe përçarjen e brendshme, gjë që i ndodhi Shqipërisë së vitit 1913, pothuaj gjatë gjithë kohës së ekzistimit të saj.

Azem Bejta zanatin e luftës e kishte të përkryer dhe për këtë dha prova gjatë dekadave. Ai luftoi dhe kërkoi që të korrigjohen padrejtësitë e Kongresit të Berlinit të vitit 1878 dhe të Konferencës së Londrës më 1913. Azem Galica thoshte troç: "Atje ku asht tokë serbe të jetë Serbi, atje ku asht tokë shqiptare të jetë Shqipëri". Përndryshe ,, për atë që ka ba e po banë krali e Serbia le ta din se kurrë nuk do të jemi miq, por anmiq të tyre".<sup>2</sup> Ai e donte një Shqipëri në kufijtë e saj të vërtetë kombëtarë.

Azem Bejta me bashkëluftëtarët u desh të përballej me ushtrinë e Serbisë, xhandarmërinë e saj, me komitët serbë, me kolonistët, pastaj me kryeçetnikët, si: Miliq Kërsta, Kostë Peçanci etj., sikundër dhe me bashkëpunëtorët e serbomëdhenjve – spiunët shqiptarë. Dihet historikisht se Serbia ishte gjithmonë e prirur për provokime dhe incidente, duke u treguar si armiku më mizor dhe më barbar në tërë historinë e Kosovës. Edhe Miss Durham theksonte se

---

2. Po aty, 90

„pushtuesit serbë ishin njëqind herë më të këqijë se sa turqit”.

Aksionet dhe luftërat e njësitit të Azem Galicës kundër Ushtrisë dhe ~~xhandarmërisë~~ serbe numërohen me dhjetëra, rreth shtatëdhjetë sish. “Kryetrimi Azem Galica, i cili ishte shumë i ashpër në luftëra kundër armikut, ndaj atyre që dorëzoheshin dhe ndaj atyre të cilët kërkonin falje ishte zemërbutë dhe dinte të falte”.<sup>3</sup> Vërtet, Azem Galica ishte jo vetëm guximtar, por edhe mjaft i zgjuar. Ai i dinte dredhitë, lajkat dhe makinacionet e serbëve dhe lirisht mund të themi se Azemi ishte figura më e ndritshme e rrezistencës në Kosovë deri në fund të jetës. Azem Galicës në zemër i vlonte urrejtja për armikun e dashuria për tokën e Dardanisë antike, sidomos për Drenicën, si djep trimash e mejdan luftërash<sup>4</sup>.

Atëqënuke arriti me forcë ushtarake exhandarmërinë drejtim të dobësimit të luftës çlirimtare shqiptare, Serbia do ta arrinte me “bisedime”, duke bërë eksperimente me “zona të lira”. Megjithatë, formimi i zonave të lira dëshmoi forcën e luftëtarëve çlirimtarë në territorin e Kosovës, ngase pushtetarët e Serbisë asokohe nuk mund të bënin më tepër. Qëllimi i tyre ishte të fitonin kohë. Kështu, mu në zemër të Drenicës krijohet zona e lirë e njohur me emrin kuptimplotë Arbana – përkatësisht “Shqipnia e Vogël”.

Shqipnia e Vogël ishte roje dhe fortesë e parë e lirisë në tokën e Drenicës dhe të Kosovës, që u formua me qëllim t’i zgjeronte kufijtë e vet të natyrshëm, ashtu si filluan shtetet fqinje përreth. Ajo, si pishtar i ndezur i lirisë duhej më fuqimisht t’i përhapte shkëndijat e

3. Mr. Ibrahim Çitaku, Azem Galica, Prishtinë 1996, 285.

4. Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë 1976, 50.

kushtrimit<sup>5</sup>. Formimi i zonës së lirë - Shqipnia e Vogël qershor 1923 - 15 korrik 1924, në fillim i takonin më shumë fshatra të komunës së Prekazit, më vonë u kufizua në fshatrat Galicë, Mikushnicë dhe Lubovec. Shqipnia e Vogël si qendër kishte Galicën<sup>6</sup>. Kështu, Drenica u kthye në një gjendje gati gjysmë të lirë, disi e pashkelur. Andaj, Shqipnia e Vogël - zemra e saj, tani e tutje duhej ta luante rolin e vet në përhapjen e shkëndijave në tërë Kosovën, siç ka ndodhur edhe me popujt fqinjë përreth kur kanë nisur formimin e shtetit të tyre. Shqiptarët është dashur që ta vazhdojnë luftën çlirimtare me një intenzitet më të fuqishëm dhe ta flakin sundimin e egër serbomadhi.

Duhet theksuar se Lëvizja Çlirimtare e Kosovës ka qenë vazhdimisht faktor dhe aleat i natyrshëm për të ndaluar çdo rrezik dhe prerë rrugën shteteve grabitçare fqinje kundër Shqipërisë politike. Për atë arsye qeveria e Beogradit donte ta zhdukte një nga pikat kryesore që vinte në rrezik sundimin serb në Kosovë e ta digjte e shkretëronte Arbaninë e Vogël<sup>7</sup>. Mirëpo, gjatë kohës së dimrit luftëtarët e Kosovës strehoheshin në Shkodër dhe në qytetet e Malësisë përreth.

Duhet nënvizuar se Serbia është përpjekur t'i thyejë e joshë me mjete të ndryshme udhëheqësit kombëtarë, e aty ku nuk kishte sukses ajo ziente gënjeshtre dhe bënte shpifje të llojllojshme. Intriga të tilla vazhdimisht janë gatuar për popullin tonë, por edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të fabrikohen në kancelaritë e errëta të Beogradit dhe Moskës. U bënë

---

5. Po aty, 212.

6. Mr. Ibrahim Çitaku, Azem Galica, Prishtinë 1996, 428.

7. Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë 1976, 215.

tentativa të tilla lajthitjeje edhe ndaj kryetrimt Azem Bejta, qoftë me para, qoftë me grada e premtime tjera të ndyra. Azem Galica gradat i fitoi me gjak. Azemi shumë herë iu deklaroi serbomëdhenjve e telallëve të tyre shqipëfolës se: „ nuk kemi dalë maleve për grada e pasuni, po për atdhe e liri. S’duem gradat e rrogat e Serbisë. Me pranue kushtet e juaja – ajo asht krejt kundër karakterit tem e bashkëluftëtarëve të mi, kjo është edhe puna ma e fëlliqtë për çdo shqiptar<sup>8</sup>. Ndërkaq, sa i përket „ bujarisë” së kralit serb, Azemi thoshte se ajo asht e lame me gjak dhe se „ na e njohim fjalën e tij, ajo asht ma e lehtë se pupla e sorrës,” kështu që deklaronte prerë: „ Serbia le ti lejë të lira tokat shqiptare deri atje ku bukës i thonë bukë e ujit ujë”<sup>9</sup>. Azem Bejta që nga fillimi e deri në fund u mundua me gjithë shpirt ta bënte një histori kombëtare e dinjitoze. Në të vërtetë kurrë nuk duhet harruar që: „Sllavët nuk lozin nga parimi i tyre. Kur kanë nevojë premtojnë male me ar. Kur e kryejnë punën kërceva lumin sikter kalit!”<sup>10</sup>.

Azem Bejta ia lëkundti më së tepërmi autoritetin Serbisë në Kosovë, duke e mbajtur nën tension shtetin serb, përkatësisht MSKS dhe e pengoi zbatimin e politikës së shkombëtarizimit të kësaj gjysmë Shqipërie të pushtuar. Prandaj, ajo ishte forma më e rëndësishme e rezistencës së këtij populli midis dy luftërave botërore. Kosova – kjo tokë e përgjakur - ia vuri gjoksin pushtuesve serbomëdhenj.

Në fakt, luftëtarët e çetave çlirimtare në Kosovë kurrë askujt nuk ia prekën gardhin, kurrë nuk sulmuan

8. Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë 1976, 91.

9. Po aty, 92.

10. Tafil Boletini, Përball sfidave të kohës, kujtime II, Tetovë 1996, 46.

përtej trevave të tyre, kurrë nuk kërkuan tokë të huaj. Ata deshën të çliroheshin, deshën lirinë e qetësinë në vatrat e tyre, meqë shpërngulja me presione të shumta për qëllime sllavizimi e kërcënonte Kosovën shqiptare. Moskundërshtimi sillte zhdukjen, ndërsa qëndresa e armatosur ishte rrugëdalja e vetme dhe shfaqje e ligjshme e vetëmbrojtjes së një populli kundër kolonizimit dhe shfarosjes së popullit shqiptar të Kosovës.<sup>11</sup>

Kryetrimi Azem Bejta e dinte fare mirë se “toka nuk do vetëm ujë, ajo është shumë e shtrenjtë. Armiqtë shumë e lakmojnë. Uji e ruan nga thatësia, gjaku e ruan nga armiqtë”<sup>12</sup>.

Rreth gjysmës së muajit – do të thotë më 14-15 korrik të vitit 1924, Serbia pabesisht e rrethon Arbaninë e Vogël me ushtri e armë të të gjitha llojeve dhe të gjinive ushtarake, me xhandarmëri, çetnikë, kolonë shovinistë serbo-malazez dhe me elementë të tjerë serbofilë, që tërësisht ishin disa mijëra forca. Në këtë fushatë të përgjakshme u vranë qindra burra, gra, pleq dhe fëmijë; tri-katër fshatra të Shqipnisë së Vogël u rrafshuan me tokë. U vranë edhe disa luftëtarë shqiptarë, në mesin e të cilëve plagoset për vdekje kryetrimi dhe komandanti i njësiteve çlirimtare të gjysmës së Shqipërisë, ndërsa disa ditë më vonë vdiq fizikisht<sup>13</sup>, por nuk vdiqën emri dhe vepra kombëtare që la trashëgim për brezat. Azem Galica ishte dhe mbeti simbol i luftës së shqiptarëve kundër Serbisë. Ai ishte emblema më e njohur e trimërisë, patriotizmit dhe sakrificës. Azemi ishte tmerr për

11. Shotë Galica heroinë e kombit, Instituti i Historisë, Prishtinë 2003, 173.

12. Po aty, 172.

13. DASSIP-Poslanstsvu u Parizu 1924, fasc.1. Pov. Br. 591.

terroristët serbomëdhenj. Është i njohur amaneti i tij (që kurrë as trupin dhe as eshtrat e tij të mos ia prekin sllavët, amanet që ka domëthënie të madhe) - fshehja e trupit dhe skena e padëgjuar ndonjëherë që ndodhi në Shpellën historike të Përçevës - Çuku që kërset, për 47 vjet në fshehtësi e besnikëri të pashoqe<sup>14</sup>.

Pra, gjatë tërë kohës 1918-1924 Azem Bejta nuk është dorëzuar asnjëherë, vetë disa herë ka hy në bisedime me përfaqësues të pushtetit. Shpesh është thirrë që të mashtrohej dhe të likuidohej, por kishte përcjellës të sigurt kombëtar.<sup>15</sup> Serbët e pabesë duke shfrytëzuar festën e Bajramit e arritën qëllimin e vet me një rrethim të hekurt prej disa mijëra vetëve. Kështu, atë që nuk e arriti me force.

Pa dyshim, rënia e Azem Bejtë Galicës ishte një humbje e madhe për gjysmën e kësaj Shqipërie të mbetur nën robëri. Populli ynë e ndjeu në shpirt humbjen e kryetrimt, i cili së bashku me Shotë Galicën e kaluan pjesën më të madhe të jetës në malet e Kosovës. Serbia edhe kësaj radhe triumfoi, pas shuarjes së Arbanisë së Vogël, meqë askush si ai nuk e mbajti të ndezur zjarrin e luftës me Serbinë deri në vitet 1997-1999, përkatësisht deri në Epokën heroike të UÇK-së me Adem Jasharin legjendar në krye.

---

14. Vërejtje: Duhet theksuar se në disa vepra të botuara për Azem Bejtën nuk përputhen datat e vdekjes fizike të kreshnikut. Kështu; Ajet Haxhiu, Shota dhe Azem Galica, Tiranë 1976, fq.237 ka datën 17 korrik 1924; Mr. Ibrahim Çitaku, Azem Galica, Prishtinë 1996, fq.480 ka datën 24 korrik 1924; Bedri Tahiri, Azem Bejtë Galica, Prishtinë 2005, fq. 160 paraqet datën 24-25 korrik 1924; Dr. Limon Rushiti, Lëvizja kaçake në Kosovë (1918-1928), Prishtinë 1981, fq. 222 e ka datën 25-26 korrik 1924. Do të ishte krejt normale që pas Shpalljes së Pavarësisë së Kosovës më 17shkurt 2008, eshtrat e Shotë Galicës të barten afër burrit – Azem Bejtës në Galicë të Drenicës.

15. Politika", 16-17-VII, 1924, Beograd.

Pra, Azem Bejta ia filloi luftës kundër sundimit osman (1910-1912), për të vazhduar kundër Serbisë pushtuese (1912-1915), ndërsa gjatë viteve (1916-1918) luftoi kundër sundimit austro - hungarez dhe atij bullgar. Faqja më e ndritshme e historisë së tij gjithsesi është lufta kundër Serbisë - përkatësisht Mbretërisë SKS nga viti 1918 – deri në gjysmën e vitit 1924. Azem Bejta luftoi me tërë qenien më se një dekadë e gjysmë dhe si i tillë rrallë se i gjendet shoku në historinë evropiane dhe më gjerë. Ai ishte dhe mbeti burim frymëzimi për gjeneratat e reja dhe duhet të zenë një vend nderi në pedestalin e figurave më të shquara të kombit tonë. Azem Bejta, në saje të luftës çlirimtare që bëri, u mbulua me lavdi, duke i bërë nder të madh Kosovës dhe Shqipërisë në përgjithësi.